



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 168

Tiranë – E premte, 25 shtator 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9222, datë 9.9.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11705
Dekret i Presidentit nr. 9223, datë 9.9.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11705
Dekret i Presidentit nr. 9226, datë 15.9.2015	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 11705
Dekret i Presidentit nr. 9227, datë 15.9.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11706
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 754, datë 16.9.2015	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Sistemin e Menaxhimit të Standardeve..... 11706
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 16.9.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për kalimin në përgjegjësinë e saj të ndjekjes dhe zbatimit të projektideve të konkursit “Edhe unë kam një ëndërr 2015”..... 11707
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 756, datë 16.9.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 503, datë 1.8.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për shërbimet funksionale të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”..... 11709
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 757, datë 16.9.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 271, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për veprimtarinë akademike në zbatimin e programit të formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës”..... 11710

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 758, datë 16.9.2015	Për ngarkimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për kryerjen e procedurave të prokurimit për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për këtë ministri.....	11710
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 760, datë 16.9.2015	Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor.....	11711
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 766, datë 16.9.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i varrezave publike të qytetit, në Bashkinë e Elbasanit.....	11715
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 767, datë 16.9.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës “Bajram Allaraj”, të Bashkisë së Tiranës.....	11716
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 768, datë 16.9.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës “Pasho Hysa”, të Bashkisë së Tiranës.....	11716
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 769, datë 16.9.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga rikonstruksioni i rrugës së “Filantos”, të Bashkisë së Tiranës.....	11717
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 770, datë 16.9.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga sistemimi dhe rikonstruksioni i infrastrukturës, ndërmjet rrugëve “Stavri Themeli”, “Babë Rexha” dhe “Ndre Mjeda”, të Bashkisë së Tiranës.....	11718
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 771, datë 16.9.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i bulevardit “Petro N. Luarasi”, të Bashkisë së Tiranës.....	11719
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 16.9.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të Tiranës së Madhe (shtesa)”.....	11720
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 108, datë 7.9.2015	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.....	11721
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 109, datë 7.9.2015	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.....	11721
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 110, datë 7.9.2015	Për licencimin e shoqërisë “Mesopotam Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Driza” (me fuqi të instaluar 3.408 mw).....	11722
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 111, datë 7.9.2015	Për licencimin e shoqërisë “Mesopotam Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	11722
	Kërkesë për shpalljen të vdekur shtetasit Veri Dika.....	11723

**DEKRET****Nr. 9222, datë 9.9.2015****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Hakan Burhan Halici
2. Ayşe Sait Kutlu (Şeref)
3. Adile Adil Kutlu
4. Arife Adil Kutlu
5. Mehmet Cafer Leyla
6. Latif (Ljatif) Bari Ajrulai (Ajrullai)
7. Mario Salvatore Dattilo
8. Btissam Abderrahim Quabil
9. Giorgio Daniele Ponti
10. Vladyslava (Vladislava) Volodymyr (Volodimir) Lanina
11. Zeynep Halit Ziya Yilmaz (Gur)
12. Hüseyin Süleyman Çetinkaya
13. Berlin Ali Riza Akin (Aykut)
14. Nihat Münir Aksu
15. Murat Selim Thaçi
16. Şeref Ihsan Demircin

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET**Nr. 9223, datë 9.9.2015****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Leonard Pjetër Preni
2. Albert Smajl Ismaili
3. Rukije Rifat Mulla (Kryeziu)
4. Avdullah Mejdin Shala
5. Ragip Mehmet Mehmeti
6. Vjosa Hamit Bala (Ahmeti)
7. Osman Hasan Ali Poyraz
8. Dinë Arif Thaçi
9. Kadrije Fazli Asllani (Dobrevë)
10. Jetmir Zendel Ismaili
11. Agim Zendel Ismaili
12. Zyhrrie Hakif Abazi (Musa)
13. Neveen Moussa Youssef Abdelkhalkek (Abdel Khalek)
14. Şevket Kail Organ
15. Brinduşa Dumitru Marashi (Ciobanu)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET**Nr. 9226, datë 15.9.2015****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Hysni Jaho Hoxhallari
2. Sadion Hysni Hoxhallari
3. Jetmira Syle Camaj
4. Gentian Ismail Sotiri
5. Nikolla Spaso Ajković (Alkaj)



6. Sllavka Niko Ajković (Dritarja)
7. Svetlana Nikolla Ajković (Alkaj)
8. Emanuela Qamil Bezhani (Sinani)
9. Elton Arqile Salavaçi
10. Klodian Telha Goxhaj
11. Nedelko Mirko Matanović (Veri)
12. Andro Ilo Stajkiq (Llazoja)
13. Desanka Velo Zllatićanin (Simoja)
14. Miroslav Mirko Zllatićanin (Tatićaj)
15. Gordana Drago Ajković (Marash)
16. Vera Llazo Antić (Sekuliq)
17. Doris Mikel Nočka
18. Alfred Sadik Shytaj
19. Valbona Telat Saraçi (Çiçe)
20. Endri Timothea Aleksi
21. Marcus Thanasi Lena
22. Klaus Kristian Arian Çitozi
23. Ilir Gori Çuko
24. Arnisa Vangjel Koçollari
25. Evelina Ndrec Lleshaj
26. Donika Pal Lleshi
27. Doniko Gjin Lleshi
28. Eduart Fiqiri Terziu
29. Liri Mustafa Opri
30. Gerti Luan Zotaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET**Nr. 9227, datë 15.9.2015****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Fatmir Petrit Zyka

2. Kastriot Hasan Roli
3. Polikseni Sotir Bastuni (Kola)
4. Liri Selman Ismaili (Stafaj)
5. Ardian Berti Pepa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM**Nr. 754, datë 16.9.2015****PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE PËR
SISTEMIN E MENAXHIMIT TË
STANDARDEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 14, të ligjit nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore për Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit (DPS). Baza e të dhënave të DPS-së quhet Sistemi i Menaxhimit të Standardeve (SMS) - *Standards Management System*.

2. Sistemi i Menaxhimit të Standardeve (SMS) përmban të dhëna për:

- standardet shqiptare dhe dokumentet e standardizimit;
- ciklin e jetës së standardeve shqiptare;
- shitjet e standardeve (faturat, numrin e faqeve, çmimin për çdo standard, porositë/kërkesat për blerje standardesh dhe statusin e tyre);
- klientët dhe palët e interesuara (subjekti/personi, qyteti, adresa, standardi/et e kërkuara);
- punën teknike të standardeve.

3. Institucioni administrues i Sistemit të Menaxhimit të Standardeve është Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.



4. Të dhënat parësore dhe dytësore të SMS-së janë, si më poshtë vijon:

4.1 Të dhënat parësore:

- Standardet shqiptare dhe dokumentet e standardizimit;

- Cikli i jetës së standardeve shqiptare;

- Të dhëna për shitjet e standardeve;

- Të dhëna për klientët dhe palët e interesuara;

- Të dhëna për punën teknike të standardeve.

4.2 Të dhënat dytësore:

- Standardet e organizatave evropiane (CEN, CENELEC, ETSI);

- Standardet e organizatave ndërkombëtare (ISO, IEC dhe ITU-T).

5. Dhënës i informacionit, sa i përket SMS-së, është Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

6. Baza e të dhënave të DPS-së shkëmben informacione me institucionet publike e private, që ushtrojnë funksione publike, sipas ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, lidhur me statusin e standardeve shqiptare dhe fushat që lidhen me to. Gjithashtu, ajo ndërvepron me databazat e organizatave evropiane e ndërkombëtare të standardizimit dhe bazohet në të drejtat dhe detyrimet e statusit të anëtarësimit të DPS-së në këto organizata.

7. Subjektet e interesuara kanë nivel aksesit si lexues dhe konsultues, lidhur me informacionin e vënë në dispozicion, nëpërmjet faqes së internetit të DPS-së (Katalogu i Standardeve Shqiptare, puna teknike me standardet dhe porositja/kërkesat *on line*).

Për punonjësit e DPS-së niveli i aksesimit përcaktohet në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të SMS-së.

7.1 Baza e të dhënave të DPS-së ka 6 nivele përdoruesish (*users' levels*):

1. Niveli Administrator;

2. Niveli Raportues (*Report*);

3. Niveli Shitës standardesh (*Sale*);

4. Niveli Standard;

5. Niveli Standard PDF;

6. Niveli Standard, Shitje dhe lexues i PDF, (*Standard, Sale and PDF Read*).

Funksionet dhe të drejtat e secilit përdorues janë në përputhje me pozicionin e punës dhe të përcaktuara në procedurat e punës, të miratuara nga drejtori i Përgjithshëm i DPS-së për secilin nga punonjësit e saj.

8. Subjekte të interesuara për SMS, janë:

- biznesi dhe shoqatat tregtare;

- shoqatat e konsumatorit;

- trupat akademike (universitetet, studentët);

- trupat inspektuese dhe testuese;

- institucionet shtetërore dhe lokale;

- personat fizikë dhe juridikë;

- komitetet teknike të DPS-së.

9. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të SMS-së së Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane e ndërkombëtare në fushën e standardizimit, do të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 755, datë 16.9.2015

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSINË E SAJ TË NDJEKJES DHE ZBATIMIT TË PROJEKTIDEVE TË KONKURISIT “EDHE UNË KAM NJË ËNDËRR 2015”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes i kalon përgjegjësinë për ndjekjen e zbatimit të projektideve fituese në kuadër të konkursit “Edhe unë kam një ëndërr 2015”, sipas listës së dhënë në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.



2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të realizojë ndjekjen e projektideve fituese nëpërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

3. Rregullat e veçanta për mënyrën e monitorimit, raportimit dhe disbursimit të fondit përkatës nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e projektideve fituese të përcaktohen me udhëzim të posaçëm të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

4. Për financimin e projektideve fituese, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t'i shtohet fondi prej 10 171 600 (dhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) lekësh.

5. Fituesve të konkursit “Edhe unë kam një ëndërr 2015” do t'i mbulohen shpenzimet, deri në 1 000 000 (një milion) lekë, për realizimin e projektideve të tyre.

6. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKS I

Fituesit e konkursit “Edhe unë kam një ëndërr 2015”:

1. Ledian Shehu nga Berati, i sapokthyer nga Anglia me ëndrrën për të kontribuar në ndërtimin e një sistemi digjital të guidës zanore për turistët që vizitojnë Beratin, përmes së cilës çdo turist do të ketë mundësinë e pajisjes me një guidë personale që e drejton dhe i shpjegon me zë në gjuhë të ndryshme rreth atraksioneve turistike në të cilat ndodhet.

2. Mimi Memiaj nga Tirana për idenë e krijimit të një shtëpie të kultivimit të arteve artizanale ku krijues artistë me eksperiencë do të punojnë së bashku me të rinjtë për të zhvilluar një treg artistësh të suvenireve bashkëkohore që pasqyrojnë traditën në tregjet brenda dhe jashtë

vendit. Kjo shtëpi artizanale do të fuqizojë artistët e rinj të këtij zhanri si të ndërtojnë një plan biznesi e të hapin pika ambulante suveniresh në vendet turistike, si të reklamojnë punimet shqiptare dhe si t'i prezantojnë ato në forume të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

3. Helidon Nauni nga Tirana, me idenë e krijimit të një muzeu shkencor, mësimor e argëtues për fëmijë ku përmes shembujve praktikë, fëmijët do të mësojnë se si ligjet e matematikës, fizikës, kimisë e shkencave të tjera veprojnë kudo në jetën tonë. Muzeu do të ndërtohet si një njësi shfaqjeje në lëvizje dhe do të udhëtojë dhe japë shfaqje edukuese e argëtuese edhe në zonat më të largëta.

4. Emanuela Zaimi do të marrë mbështetje të pjesshme për Fondacionin Down Syndrom Albania, me qëllim krijimin një biznes social të paketimit e shitjes së luleve në të cilin do të punësohen persona me sindromën down dhe të ardhurat do të shkojnë për trajtimin e fëmijëve me këtë sindromë.

5. Pezana Rexha nga Tirana për zgjerimin e biznesit social “Design by Pana” i cili punëson personat nga grupet me nevoja të veçanta për të prodhuar mobilje dhe aksesore për ambiente të brendshme me përqasje miqësore ndaj ambientit përmes përdorimit të drurit të vjetër dhe mbetjeve urbane. Me realizimin e kësaj ëndërr do të mundësohet rritja e kapaciteteve prodhuese dhe rritja e numrit të personave me aftësi të kufizuara të punësuar në këtë sipërmarrje sociale dhe ekologjike.

6. Mivan Peçi nga Gjirokastra, për të kryer identifikimin molekular të varieteteve autoktonë shqiptar të ullirit. Përmes kësaj ideje, 22 varietete autoktonë të ullinjve tanë, të cilat janë të konservuara në Bankën e Germoplazmës në Vlorë do të plotësohen me analizat përkatëse që bëjnë më pas të mundur të procedohet me certifikimin, regjistrimin dhe ruajtjen e këtyre varieteteve të cilat janë në rrezik zhdukjeje.

7. Brunilda Topciu nga Kruja për ndërtimin e një ferme të vogël në një tokë të lënë djerrë, me prodhime biologjike me ullishte, vresht, bimë medicinale dhe 50 koshere për rritjen e bletëve ku do të punësohen fillimisht katër persona e më pas shumë të tjerë nga fshati që do të kultivojnë e shesin produktet e biofermës.

8. Genti Selenica nga Tirana, për idenë e tij të promovimit të produkteve tipike shqiptare



nëpërmjet një platforme informatike inovative të integruar me aplikacion mobile (*iOs/ Android*) dhe rrjete sociale (*Facebook, Twitter, Google my Business*), marketimi i të cilave do të rrisë njohjen, konsumin e tyre dhe për rrjedhojë rritjen e prodhimit.

9. Klodita Karabina nga Picari, për ngritjen e një ferme të vogël me 6 lopë për të siguruar vetëpunësimin dhe mbështetjen e studimeve të vajzës së saj.

10. Erjon Roku emigrant në Itali, i cili dëshiron të sjellë eksperiencën e tij të bukur nga vendi fqinj duke organizuar në Shqipëri festivalin e ushqimeve të shpejta shqiptare ku gastronomë dhe ambulantë të ndryshëm do të promovojnë kuzhinën lokale, shqiptare dhe atë ndërkombëtare në formën e një "food festival" shëtitës nëpër qytete të ndryshme të vendit.

11. Mico Kasapi nga Gjirokastra, mjeshtër i cirkut, i cili do të mbështetet për idenë e krijimit të një grupi të ri me fëmijë për t'i stërvitur, trajnuar dhe zbuluar talentet e reja të cilat do të sigurojnë vazhdimësinë e traditës 50-vjeçare të cirkut të Gjirokastrës.

12. Ari Vogli nga grupi ZOMEG, për krijimin e një platforme e cila do të funksionojë si *freelancer*, një lloj *proxy* për freelancerat që të prezantohen denjësisht, platformë e cila do të ofrojë punësim për mbi 300 të rinj e të vjetër në Shqipëri, do të krijohen klasa kursesh dhe suporti për të gjithë të rinjtë që duan të vazhdojnë në këtë fushë(falas).

VENDIM

Nr. 756, datë 16.9.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 503, DATË 1.8.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET FUNKSIONALE TË QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 503, datë 1.8.2007, të Këshillit të Ministrave, tarifa e shërbimit "Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt" ndryshohet sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr. 1

	Shërbimi	Tarifa në lekë
11	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, me 1 fletë deri në 20 fletë	100
11/1	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, me 21 fletë deri në 100 fletë	500
11/2	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, mbi 100 fletë.	1 000

**VENDIM****Nr. 757, datë 16.9.2015****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 271, DATË 6.4.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
VEPRIMTARINË AKADEMIKE NË
ZBATIMIN E PROGRAMIT TË
FORMIMIT FILLESTAR DHE
VAZHDUES NË SHKOLLËN E
MAGJISTRATURËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 47, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 15, të ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 271, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Lejohet të aktivizohen, si ekspertë, lektorë, akademikë dhe profesorë të huaj, të cilët do të paguhen me honorarë për orë pjesëmarrjeje në procesin e mësimdhënies në Shkollën e Magjistraturës, në programin e formimit fillestar dhe atij vazhdues. Masa e pagesës nuk duhet të jetë më e madhe se 5-fishi i pagesës për orët mbi normë, për kategorinë “profesor” dhe jo më shumë se 50 orë mësimore në vit. Ekspertëve dhe lektorëve të huaj u mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, për jo më shumë se 5 ditë. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtyre pagesave, përballohen nga fondet e parashikuara për mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës”.

2. Në pikën 10, fjalët “... 0.3-0.5 orë mësimore ...” zëvendësohen me “... 0.5-1 orë mësimore ...”.

3. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1. Për miratimin e publikimeve dhe botimeve në Shkollën e Magjistraturës ngrihet Bordi i Redaktorëve, i cili është organ vendimmarrës. Bordi i Redaktorëve përbëhet nga 7 deri në 9 anëtarë, të cilët propozohen nga drejtori i Shkollës së Magjistraturës dhe miratohen nga

Këshilli Drejtues i saj. Anëtarët e bordit zgjidhen nga radhët e personaliteteve me tituj dhe grada shkencore, si dhe të pedagogëve me eksperiencë mbi 5vjet në Shkollën e Magjistraturës, me përjashtim të drejtorit të Shkollës, i cili është gjithmonë anëtar i bordit.”.

4. Në lidhjen nr. 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “g” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“g) Hartimi i tezave të provimit të pranimit për fazën e parë, 1 tezë, 1500 (një mijë e pesëqind) lekë dhe për fazën e dytë, 1 tezë 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë.”.

b) Pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj”, me këtë përmbajtje:

“gj) Komisioni i hartimit të testit të shëndetit mendor dhe psikologjik, 1 test/20 orë mësimore.”.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara për Shkollën e Magjistraturës, brenda tavaneve të shpenzimeve buxhetore të miratuara për vitet 2015-2018.

6. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM**Nr. 758, datë 16.9.2015****PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË
MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT PËR PAJISJEN ME
DEKODERA TË FAMILJEVE NË
NEVOJË, PËRFITUESE NGA SKEMA E
NDIHMËS EKONOMIKE, DHE PËR NJË
SHITESË FONDI NË BUXHETIN E
VITIT 2015, MIRATUAR PËR KËTË
MINISTRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të nenit 10, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe të ligjit



nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për kryerjen e procedurave të prokurimit për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike.

2. Fondi prej 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, që do të përdoret për kryerjen e procedurave të prokurimit për vitin 2015, të shtohet në buxhetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, miratuar për vitin 2015. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë I Këshillit të Ministrave.

3. Pjesa tjetër e fondeve, prej 180 000 000 (njëqind e tetëdhjetë milionë) lekësh të përballohet nga buxheti i shtetit për vitin 2016. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për planifikimin e fondit të nevojshëm në buxhetin e saj për vitin 2016.

4. Ngarkohet Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, të realizojë shpërndarjen e dekodereve të familjet përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, sipas udhëzimit të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 760, datë 16.9.2015

PËR KËRKESAT PËR GJURMININ E USHQIMIT DHE USHQIMIT PËR KAFSHË PËRGJATË ZINXHIRIT USHQIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, me

propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë bazën për një sistem efikas të gjurmimit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë të gjithë zinxhirit ushqimor, duke vendosur kushtet minimale të detyrueshme për gjurmueshmërinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë nën kontrollin e operatorëve të biznesit ushqimor, në mënyrë që të reduktojë ose të eliminojë çdo rrezik të shkaktuar nga vendosja në treg e ushqimit dhe ushqimit për kafshë të pasigurt.

2. Kërkesat specifike për shtrirjen e gjurmueshmërisë varen nga natyra e produktit, praktikat e fermave apo veprimet e tjera përgjatë zinxhirit agroushqimor, nga specifikimet e klientit dhe nga kërkesat e praktikave më të mira.

3. Ky vendim zbatohet për çdo person fizik ose juridik, të regjistruar dhe të licencuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, që ushtron aktivitet publik apo privat me qëllim fitimi ose jo, në fushën e prodhimit (përfshirë prodhimin primar), përpunimit, shpërndarjes dhe furnizimit të ushqimit e të ushqimit për kafshë, përfshirë këtu importuesit dhe çdo ndërmjetës tregtar, pa marrë parasysh nëse ata marrin zotërimin fizik të ushqimit dhe ushqimit për kafshë në fjalë. Ky vendim zbatohet edhe për aktivitete bamirësie në varësi të organizimit dhe vazhdimësisë së aktivitetit të tyre.

II. PËRKUFIZIME

1. Për qëllime të këtij vendimi, termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Autoritetet kompetente”, ministria përgjegjëse për fushën e ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

b) “Furnizim”, transferimi i pronësisë mbi produktet ushqimore ose ushqimin për kafshë ose të kafshëve që prodhojnë ushqim. Në çdo rast, për qëllim të këtij vendimi, ndërmjetësit ose agentët do të konsiderohen si furnizues, pavarësisht nëse marrin zotërimin fizik të produktit apo jo.

c) “Sistemi” dhe “procedura”, një mekanizëm i strukturuar, i aftë për të shpërndarë informacionin e kërkuar sa herë që kërkohet nga autoritetet kompetente.



ç) “Përgjegjshmëria e duhur”, ndërmarrja në rrethana të caktuara nga operatori i biznesit ushqimor, me të gjithë përgjegjësinë e kërkuar, të plotësimit të kërkesave të gjurmueshmërisë, dhe dhënia në vijim e informacionit për autoritetet.

d) “Dërgim”, veprimi i dërgimit të produktit ushqimor ose ushqimit për kafshë në një destinacion specifik.

dh) “Dërgesa e ngarkesave”, dorëzimi i produkteve ushqimore ose ushqimit për kafshë te një transportues, i cili e transporton atë te një subjekt i caktuar me qëllim shitjeje.

e) “Dërguesi” ose “dorëzuesi”, një person fizik ose juridik apo një person i autorizuar i tij, i cili dërgon ose dorëzon ushqimin apo ushqimin për kafshë te një person fizik ose juridik tjetër, me qëllim shitjen e tij. Emri i personit ose kompanisë (zakonisht shitësi), i cili dorëzon një ngarkesë te një transportues për t’u transportuar te marrësi i ngarkesës (zakonisht blerësi), shënohet në dokumentet e transportit. Pronësia (titulli) e ngarkesave mbetet me dërguesin e ngarkesës derisa marrësi i ngarkesës paguan për to në mënyrë të plotë.

ë) “Marrësi i produktit”, një person fizik apo juridik që vepron si një agjent në emër të dërguesit, në shitjen e ngarkesës i cili kujdeset në mënyrë të arsyeshme për produktin për sa kohë ngarkesa është në zotërimin e tij. Një përfaqësues (zakonisht një blerës) përcaktohet nga dërguesi i ngarkesës (zakonisht një shitës) në dokumentet e transportit si një përfaqësues, i cili do të dorëzojë ngarkesën në portin e destinacionit. Marrësi i ngarkesës do të konsiderohet si pronari i dërgesës për qëllim të plotësimit të deklaratës doganore dhe për të paguar detyrimet e taksat. Në çdo rast, pronësia formale mbi ngarkesën do të transferohet te marrësi i ngarkesës vetëm pas pagesës së plotë për to.

f) “Parti malli”, sasia apo ngarkesa e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë të prodhuara dhe/ose të shpërndara në një kohë.

g) “Tërheqje nga tregu”, çdo masë që synon ndalimin e shpërndarjes, të paraqitjes dhe të ofrimit të një produkti të rrezikshëm për konsumatorët ose çdo masë që synon parandalimin e një ushqimi ose ushqimi për kafshë në zinxhirin e furnizimit nga bëhet i disponueshëm për treg.

gj) “Kthim”, çdo masë që synon kthimin e një produkti të rrezikshëm me të cilin është furnizuar apo i është vënë në dispozicion konsumatorit nga prodhuesi apo shpërndarësi.

2. Të gjithë termat e tjerë të përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim siç përcaktohet në nenin 3, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar.

III. KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR GJURMUESHMËRINË E USHQIMIT DHE USHQIMIT PËR KAFSHË

1. Operatori i biznesit ushqimor dhe ushqimit për kafshë duhet të krijojë një sistem të efektshëm të gjurmueshmërisë, në mënyrë të tillë që çdo tërheqje e nevojshme e produktit të kryhet saktësisht dhe specifikisht, si dhe të jepen informacionet e nevojshme për konsumatorët dhe autoritetet kompetente.

2. Gjatë krijimit të sistemit të gjurmueshmërisë, në përputhje me pikën 1, të këtij kreu, operatori i biznesit ushqimor ose ushqimit për kafshë duhet të jetë në gjendje të identifikojë çdo person juridik apo fizik, nga i cili furnizohet me ushqime dhe/ose ushqim për kafshë dhe/ose lëndë të parë dhe ataqë ai ka furnizuar me ushqime dhe/ose ushqim për kafshë dhe/ose lëndë të parë (“një hap mbrapa–një hap përpara”).

3. Sistemi i gjurmueshmërisë për çdo operator të biznesit ushqimor apo ushqimit për kafshë duhet të ngrihet dhe të projektohet në mënyrë të tillë që të ndjekë lëvizjen fizike të produktit dhe të organizohet në një mënyrë të tillë që të mundësojë shpërndarjen e saktë të informacionit të shpejtë me anë të mbajtjes së faturave të transaksioneve përkatëse, si dhe të dokumenteve të tjera të nevojshme, siç përcaktohen në këtë vendim.

4. Identifikimi vetëm i emrit të personit fizik ose juridik që shpërndan fizikisht ushqimin dhe/ose ushqimin për kafshë dhe/ose lëndët e para nuk konsiderohet i mjaftueshëm për zbatimin e dispozitave të këtij vendimi.

5. Pikat e shitjes me pakicë nuk kanë detyrimin për të dokumentuar apo regjistruar shitjen e ushqimit ose ushqimit për kafshë te konsumatori i fundit.

6. Në rastin e tregtisë me pakicë, midis operatorëve të biznesit ushqimor, të tillë si një supermarket dhe një restorant, zbatohen kërkesat e gjurmueshmërisë të parashikuara në dispozitat e këtij vendimi.



7. Sistemi i gjurmueshmërisë brenda një operatori të biznesit ushqimor duhet të lejojë që informacioni i mësipërm të jetë i vlefshëm për ministrinë dhe/ose AKU-në me kërkesë të tyre.

8. Çdo operator i biznesit ushqimor ose ushqimit për kafshë duhet të krijojë një sistem të brendshëm të gjurmueshmërisë. Sistemi i brendshëm i gjurmueshmërisë dhe lloji i të dhënave e niveli i detajimit të tyre përcaktohen nga operatori i biznesit ushqimor ose ushqimit për kafshë në përpjesëtim me natyrën dhe madhësinë e biznesit ushqimor ose ushqimit për kafshë.

9. Në rastet kur transporti dhe magazinimi janë veprimtari të integruara brenda të njëjtit operator të biznesit ushqimor ose ushqimit për kafshë, biznesi si një i tërë duhet të jetë në përputhje me dispozitat e pikës 2, të këtij kreu. Për njësinë e transportit, ruajtja për produktet e furnizuara te konsumatorët mund të konsiderohet si e mjaftueshme për aq kohë sa njësitë e tjera të këtij biznesi ruajnë të dhënat mbi produktet e marra nga furnizuesit.

10. Operatori i biznesit duhet të krijojë një sistem gjurmueshmërie, i cili të mundësojë, në çdo kohë, gjetjen e vendndodhjes së ushqimit/usqimit për kafshë/lëndëve të para që ai mban në magazinat e tij dhe kontrollon përdorimin e këtyre produkteve në produktet përfundimtare. Gjatë zbatimit të kësaj dispozite, operatori i biznesit ushqimor duhet të tregojë kujdesin dhe përgjegjshmërinë e duhur.

11. Në rastet e proceseve komplekse të prodhimit dhe / ose përpunimit, produktit përfundimtar i jepet një kod gjurmueshmërie /lot-i, i cili përmban datën e kodit, kohën e prodhimit/përpunimit, numrin e lot-it, duke lejuar prodhimin të jetë i grupuar dhe të japë një lidhje mbrapa me lëndët e para të përdorura, kohën e prodhimit etj.

12. Në rastet e dërgesave, produktet mund të grupohen në paleta ose në kuti, të cilave mund t'u jepen kode të veçanta identifikimi për përdorim në dërgesat dhe furnizimet vijuese përgjatë gjithë zinxhirit shpërndarës.

13. Operatori i biznesit ushqimor dhe/ose ushqimit për kafshë duhet të mbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) Emrin, adresën e furnizuesit, si dhe identifikimin e produkteve të furnizuara;

b) Emrin, adresën e klientit, si dhe identifikimin e produkteve të dorëzuara;

c) Datën dhe, nëse është e nevojshme, kohën e transaksionit/dorëzimit;

ç) Volumn kur është e nevojshme ose sasinë;

d) Identifikimin e njërive/pakove (grupeve) të të gjithë përbërësve dhe produkteve;

dh) Numrin e regjistrimit të operatorëve të biznesit ushqimor dhe/ose ushqimit për kafshë dhe/ose numrin e licencës.

14. Çdo sistem tjetër ekzistues për identifikimin e produkteve, i krijuar në përputhje me dispozitat të veçanta të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, mund të përdoret për të plotësuar kërkesat e krijuara nga ky vendim, për sa kohë lejon identifikimin e furnizuesit dhe të marrësit të produktit gjatë të gjitha fazave të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes.

15. Dokumentacioni dhe të dhënat e parashikuara për regjistrim nga ky vendim mbahen nga operatori i biznesit ushqimor në formë shkresore ose në formë elektronike.

16. Në rast se të dhënat e gjurmimit të ruajtura në formë të printuar nuk përmbajnë detaje mbi kohën dhe datat e dërgesave, këto detaje duhet të regjistrohen në mënyrë specifike. Kur brenda të njëjtës ditë ka pasur më shumë se një dërgesë, atëherë duhet të regjistrohet koha për secilën dërgesë të asaj dite.

17. Të dhënat e sistemit të gjurmueshmërisë duhet të jenë të organizuara në mënyrë të tillë që të bëhet i mundur konsultimi i tyre menjëherë pas kërkesës së bërë, duke mënjeluar çdo vonesë pa shkak, sidomos rastet e kthimit të produkteve ushqimore dhe/ose ushqimit për kafshë e të tërheqjes së tyre nga tregu.

18. Të dhënat e sistemit të gjurmueshmërisë ruhen për tre vjet nga data e regjistrimit të tyre. Operatori i biznesit mund të vendosë ta zgjatë këtë periudhë.

IV. KËRKESAT E VEÇANTA TË GJURMUESHMËRISË PËR AKTIVITETET NË NIVEL FERME

1. Çdo individ apo subjekt, i cili ushtron aktivitet në nivel ferme, duhet të mbajë të regjistruara të dhënat e mëposhtme, për aq kohë sa këto të dhëna mund të ofrojnë informacionin e duhur në kuadër të sistemit të gjurmueshmërisë së ushqimit dhe ushqimit për kafshë:

a) Sasinë e farave e fidanëve të blerë dhe origjinën e tyre;



- b) Çdo blerje për plehrat ose plehrat organike;
- c) Menaxhimin e inputeve në bazë të prodhimit;
- ç) Çdo rast të përdorimit të pesticideve;
- d) Çdo rast të shkëmbimit të plehut organik me ferma të tjera;
- dh) Blerjet dhe shitjet e kafshëve;
- e) Shitjet e të korrave me sasinë dhe destinacionin përkatës;
- ë) Blerjet e produkteve veterinarë dhe përdorimin e tyre sipas kafshëve;
- f) Ushqimin e blegtorisë dhe regjimin e të ushqyerit për çdo kafshë.

2. Informacioni i kërkuar sipas pikës 1 përditësohet çdo ditë.

V. KËRKESAT SPECIFIKE TË GJURMUESHMËRISË PËR USHQIMET E PAPËRPUNUARA DHE TË PËRPUNUARA ME ORIGJINË SHTAZORE

1. Dispozitat e këtij kreu nuk zbatohen për ushqimet që përmbajnë njëkohësisht produkte me origjinë bimore dhe produkte të përpunuara me origjinë shtazore. Për këtë kategori produktesh aplikohen rregullat e përgjithshme sipas dispozitave të parashikuara në këtë vendim.

2. Operatori i biznesit ushqimor, si subjekti dërgues i ushqimeve me origjinë shtazore, i jep operatorit të biznesit ushqimor (i cili është marrës i këtij produkti), si dhe sa herë që kërkohet autoriteteve kompetente informacionin e mëposhtëm:

- a) Një përshkrim të qartë të produktit;
- b) Të dhëna për volumin apo sasinë e produktit;
- c) Emrin dhe adresën e operatorit të biznesit ushqimor, i cili ka shpërndarë (dërguar) produktin;
- ç) Emrin dhe adresën e dërguesit nëse është i ndryshëm nga operatori i biznesit ushqimor, i cili ka shpërndarë (dërguar) produktin;
- d) Emrin dhe adresën e operatorit ushqimor, tek i cili është shpërndarë (dërguar) produkti;
- dh) Emrin dhe adresën e marrësit të produktit, në rast se ky është i ndryshëm nga operatori i biznesit, të cilit i është shpërndarë (dërguar) produkti;
- e) Një referencë që identifikon në mënyrë të përshtatshme njësinë, partinë e mallit apo dërgesën;
- ë) Datën e dërgimit.

3. Në dokumentin, që përmban përshkrimin e produktit, të qëllimit dhe të sasisë së tij, deklarohen në çdo rast të paktën kushtet e ruajtjes e të magazinimit, lloji i materialit të ambalazhimit,

madhësia e ambalazhimeve individuale, numri i produkteve të ambalazuara. Në rastin e ambalazhimeve të mëdha, sasia e produkteve të ambalazuara e shprehur në numrin e njësisë dhe peshën.

4. Në rastin kur operatori i biznesit ushqimor është njëkohësisht edhe pronari edhe subjekti nga ku është dërguar produkti, është i mjaftueshëm përcaktimi i emrit dhe i adresës së tij.

5. Në rastin kur operatori i biznesit ushqimor është vetëm pronar i produktit, por produkti është prodhuar ose furnizuar nga një operator tjetër i biznesit ushqimor, në dokumentacion duhet të jepet informacioni përkatës për të dy operatorët e biznesit ushqimor.

6. Informacioni i kërkuar sipas pikës 1, të kreut IV, të këtij vendimi, jepet në çdo rast si informacion shtesë së bashku me çdo informacion tjetër të kërkuar sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit në fuqi në lidhje me gjurmueshmërinë e ushqimit me origjinë shtazore.

7. Operatori i biznesit ushqimor duhet t'i sigurojë të dhënat pa vonesë, sa herë që kjo i kërkohet nga autoritetet kompetente, si dhe në kuadër të hetimit epidemiologjik. Furnizuesi i produktit e vë në dispozicion informacionin e kërkuar në formën më të përshtatshme, duke pasur parasysh që të dhënat e kërkuara në pikën 2, të këtij kreu, të jenë lehtësisht dhe qartësisht në dispozicion të operatorit të biznesit, i cili është furnizuar me këtë produkt.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Shkeljet e dispozitave të këtij vendimi trajtohen sipas përcaktimeve të shkronjës “m”, të nenit 68, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 mars 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 766, datë 16.9.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT,
NË BASHKINË E ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i varrezave publike të qytetit, në Bashkinë e Elbasanit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Elbasanit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerën 3 008 100 (tre milionë e tetë mijë e njëqind) lekë, për

sipërfaqen 11 100 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind) m² tokë “arë”.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 3 008 100 (tre milionë e tetë mijë e njëqind) lekësh të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Elbasanit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Elbasanit.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Elbasanit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 11 100 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind) m² tokë “arë”, për ndërtimin e varrezave publike të qytetit, të bëhet në favor të Bashkisë së Elbasanit.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia e Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**Lista emërore e personave dhe e pronave që do të shpronësohen për
ndërtimin e varrezave publike të qytetit të Elbasanit**

ZK 8522

Nr	Bashkëpronari	Nr	Vërtetim pronësie				Tokë arë			Banesa		Njësi				Shhpronësim	Vërtetim pronësie
			Pjesë	m2			shpronës.	çmimi	shpronsim	çmim	shpr.	Sip njës. m2	çmimi	shpr.	Shuma		
				toke arë	ban	njësi										m2	
që shpronësohet		Pas.															
1	Adile Kamer Dylgjeri(Sulova)	18/2 7	4	0,00	0,00	1850,00	271	501350,00	0,00		0,00	0,00	0,00	0,00	501350,00	Konfirmuar ZVRPP	
2	Nashifer Kamer Shyti (Sulova)		4	0,00	0,00	1850,00	271	501350,00	0,00		0,00	0,00	0,00	0,00	501350,00		
3	Hismete Kamer Sulova		4	0,00	0,00	1850,00	271	501350,00	0,00		0,00	0,00	0,00	0,00	501350,00		
4	Naim Kamer Sulova		4	0,00	0,00	1850,00	271	501350,00	0,00		0,00	0,00	0,00	0,00	501350,00		
5	Fatmire Kamer Stafa (Sulova)		4	0,00	0,00	1850,00	271	501350,00	0,00		0,00	0,00	0,00	0,00	501350,00		
6	Kamber Ali Sulova		1,3	0,00	0,00	616,67	271	167116,62	0,00		0,00	0,00	0,00	0,00	167116,62		
7	Alketa Ali Dedja		1,3	0,00	0,00	616,67	271	167116,62	0,00		0,00	0,00	0,00	0,00	167116,62		
8	Klevis Ali Sulova		1,3	0,00	0,00	616,67	271	167116,62	0,00		0,00	0,00	0,00	0,00	167116,62		
Total			24	0,00	0,00	11100,00	271	3008099,86	0,00		0,00	0,00	0,00	0,00	3 008 099,86		

**VENDIM****Nr. 767, datë 16.9.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I RRUGËS “BAJRAM ALLARAJ”, TË
BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës “Bajram Allaraj”, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, për sipërfaqen prej 300 (treqind) m² truall, në vlerën 10 859 100

(dhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 10 859 100 (dhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind) lekësh të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Tiranës të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 300 (treqind) m² truall për ndërtimin e rrugës të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për ndërtimin
e rrugës së "Bajram Allaraj"**

NR.	EMËR	MBIEMËR	Z.KADAS.	NR.PAS.	Tr.Pergj./m ²	Tr.prek./m ²	ÇMIMI /m ²	VLEFTA
1	Bashkëpronaret	HYKA	8190	3/252	4550	300	36197	10.859.100
							Shuma	10.859.100

VENDIM**Nr. 768, datë 16.9.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS “PASHO
HYSA”, TË BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561,

datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës “Pasho Hysa”, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.



2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me sipërfaqe 1 764 (një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) m², me vlerë të përgjithshme 53 024 076 (pesëdhjetë e tre milionë e njëzet e katër mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 53 024 076 (pesëdhjetë e tre milionë e njëzet e katër mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatin e parashikuar nga Bashkia e Tiranës.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë “truall”, prej 1 764 (një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) m², për ndërtimin e rrugës, të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia e Tiranës dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për rikonstruksionin e rrugës “Pasho Hysa”

Nr	EMER MBIEMER	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	Sipërfaq. Përgj./ m ²	SIP. Tr. të prekur / m ²	Çmimi për m ²	Vlefte në lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë
1	Milto Ngjel Ngjela	8180	11/140	200	28	30.059	841.652	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
2	Gëzim Ali Demiri	8180	9/267	330	15	30.059	450.885	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
3	Mexhit Shaqir Cenaj	8180	9/129	518	11	30.059	330.649	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
4	Shyqyri Dina	8180	9/298	507	10	30.059	300.590	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
5	Bajram Çupi	8180	9/224	520	21	30.059	631.239	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
6	Adriatik Ivzi Nazarko	8180	9/276	300	30	30.059	901.770	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
7	Bashkpronarët Kaimi	8180	9/318	24.874	659	30.059	19.808.881	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
8	Dhimiter Qiro Lena	8180	9/211	203	25	30.059	751.475	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
9	Avni Bajram Muça	8180	9/128	592	8	30.059	240.472	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
10	Petrit Mumajesi	8180	9/126	780	27	30.059	811.593	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
11	Trashigimtarët Mumajesi	8180	11/80	5353	191	30.059	5.741.269	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
12	Nimete Çela	8180	9/315	215	22	30.059	661.298	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
13	Nimete Çela	8180	9/529	2182	582	30.059	17.494.338	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
14	Shoq. REAL ESTATE	8180	11/76	266	50	30.059	1.502.950	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
15	BALLKAN DINAMIC shpk	8180	9/110	310	59	30.059	1.773.481	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
16	Baftjar Ceka	8180	9/210	202	26	30.059	781.534	Shkr.nr.prot.6839/1,dt.10.03.15
					1764	Shuma	53.024.076	lekë

VENDIM

Nr. 769, datë 16.9.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS SË “FILANTOS”, TË BASHKISË SË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen

në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga rikonstruksioni i rrugës së “Filantos”, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.



3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me sipërfaqe 59 (pesëdhjetë e nëntë) m², me vlerë 2 110 017 (dy milionë e njëqind e dhjetë mijë e shtatëmbëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 110 017 (dy milionë e njëqind e dhjetë mijë e shtatëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë “truall”, prej 59 (pesëdhjetë e nëntë) m², për ndërtimin e rrugës, të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia e Tiranës dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për ndërtimin e rrugës së Filantos.

NR.	EMËR MBIEMËR	Zona Kad.	NR. Pas.	Sipërfaq. Pergj. m ²	Sipërfaq. Prekur m ²	Çmimi per m ²	Vlefte ne lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë
1	Eduard Fran Kaçi	8330	4/313	500	59	35763	2.110.017	Shkr.nr.prot.11286,dt.02.07.2013
						Shuma	2.110.017	

VENDIM

Nr. 770, datë 16.9.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA SISTEMIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I INFRASTRUKTURËS, NDËRMJET RRUGËVE “STAVRI THEMELI”, “BABË REXHA” DHE “NDRE MJEDA”, TË BASHKISË SË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket

nga sistemimi dhe rikonstruksioni i infrastrukturës ndërmjet rrugëve “Stavri Themeli”, “Babë Rexha” dhe “Ndre Mjeda”, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet, sipas vlerës përkatëse, për sipërfaqen prej 28 (njëzet e tetë) m² truall, në vlerën e përgjithshme 583 380 (pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 583 380 (pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tetëdhjetë) lekësh të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Tiranës të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.



8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 28 (njëzet e tetë) m² truall për ndërtimin e rrugës të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për sistemimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës ndërmjet rrugëve "Stavri Themeli", "Babë Rexha" dhe "Ndre Mjeda"

NR.	EMËR	MBIEMËR	Zona Kadastr.	Nr. Pasurisë	Sip. Përgj. Truall /m ²	Sip. Prekur Truall /m ²	Çmimi në m ²	Vlefte në lekë	Konfirmimi i ZVRPP
1	Artan	Nuriu	8220	N - 7/212	28	28	20,835	583,380	Konf.nr.5732/1prot, dt/14.06.2012
Shuma								583,380	

VENDIM

Nr. 771, datë 16.9.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I BULEVARDIT "PETRO N. LUARASI", TË BASHKISË SË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i bulevardit "Petro N. Luarasi", sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë "truall",

me sipërfaqe të përgjithshme 50, 2 (pesëdhjetë presje dy) m², në vlerën 2 867 725 (dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 867 725 (dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë "truall", prej 50, 2 (pesëdhjetë presje dy) m², për ndërtimin e rrugës, të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia e Tiranës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për ndërtimin e Bulevardit "Petro Nini Luarasi"

NR.	EMËR	MBIEMËR	Zona Kadstr.e	Nr. Pasur.	Sip. Përgj. Tr. në m ²	Sip. Prekur. Tr. në m ²	Çmimi për m ²	VLEFTA	Konfirmimi ZVRPP
1	Mandeta, Brunilda Gjata dhe Frida, Petrit Asllani		8160	3/1093	28,2	28,2	57,126	1.610.953	Shkr.nr.prot.21550/1, dt.18.12.13
2	Ylli Tabaku me bashkëpronarë		8160	3/379	22	22	57,126	1.256.772	Shkr.nr.prot.23304/1, dt.17.03.14
					50,2 m ²		Shuma	2.867.725	

**VENDIM****Nr. 772, datë 16.9.2015****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I
PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I SISTEMIT
TË KANALIZIMIT TË TIRANËS SË
MADHE (SHTESA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë. 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të Tiranës së Madhe (shtesa)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës- Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, me sipërfaqe 16 269 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 7 288 512 (shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 7 288 512 (shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës- Kanalizimeve, zëri “Kosto lokale, për projektin e kanalizimeve të Tiranës së Madhe”, me kod projekti M061489.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve.

6. Shpronësimi të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të objektit në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të objektit në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
SEKTORI I SHPRONESIMEVE
DREJTORIA E PERGJITHSHE UJESJELLES KANALIZIME

Lista e pronareve qe shpronsohen nga “Përmirësimi i Sistemit të kanalizimit të Tiranës së Madhe”(Shtesat).

NR	Pronari			Zona Kad.	Nr. Pas.	Volum	Faqe	Lloji Pas.	Sip. Totale (m2)	Vleresimet			Shenime
	Emri	Atesia	Mbiemri							Sip. shpronsim (m2)	Cmimi lek/m2	Vlera (leke)	
1	ISLAM	HYSEN	BODLLI	3866	123/5/I	1	159	Are	3895	3895	448	1744960	Konfirmuar ZVRPP
2	ILJAZ	XHEVDET	MURRANI	3866	123/20	14	96	Are	1700	1700	448	761600	Konfirmuar ZVRPP
3	ILJAZ	XHEVDET	MURRANI	3866	123/21/I	35	210	Are	1700	1366	448	611968	Konfirmuar ZVRPP
4	ARBEN	ARIF	BODLLI	3866	123/22	14	98	Are	1700	1322	448	592256	Konfirmuar ZVRPP
5	FLAMURI	HAXHI	BODLLI	3866	123/23	14	99	Are	1700	1048	448	469504	Konfirmuar ZVRPP
6	RASIM, IRAKLI, AVNI, NIKO	ISUF	NELA	3866	123/26	22	80	Are	2600	2600	448	1164800	Konfirmuar ZVRPP
7	ISHE		HOXHA	3866	123/27	22	94	Are	5000	72	448	32256	Konfirmuar ZVRPP
8	DEMIR	BEQIR	BODLLI	3866	123/28	22	95	Are	3400	1266	448	567168	Konfirmuar ZVRPP
9	NAZIF	HAKI	SPAHIU	3866	203/5	19	218	Are	3000	3000	448	1344000	Konfirmuar ZVRPP
SHUMA										16269		7288512	

VENDIM

Nr. 108, datë 7.9.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.9.2015, mbasi shqyrtoi draft – licencën dhe relacionin e përgatitur nga grupi i punës, për miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 109, datë 7.9.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.9.2015, mbasi shqyrtoi draft – licencën dhe relacionin e përgatitur nga grupi i punës, për miratimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

**VENDIM****Nr. 110, datë 7.9.2015****PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“MESOPOTAM ENERGY” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“DRIZA” (ME FUQI TË INSTALUAR
3.408 MW)**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2, germa “a” dhe 110 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5 pika 1, germa “a”, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.9.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Mesopotam Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Mesopotam Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordin e ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Mesopotam Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Driza”, me fuqi të instaluar 3.408 MW, për një afat 30 - vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 111, datë 7.9.2015****PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“MESOPOTAM ENERGY” SHPK, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2, germa “d” dhe 110 të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 4 pika 1 germa “g”, neni 5 pika 2 dhe neneve 13 e 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordin e Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.9.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Mesopotam Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Mesopotam Energy” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10 gjerat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordin e ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Mesopotam Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 30 - vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasi Emiljano Dika, i biri i Verit dhe i Trendelinës, i datëlindjes 13.2.1986, lindur dhe banues në fshatin Mbrostar Fier, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier shpalljen të vdekur të babait të tij, shtetasit Veri Dika.

KËRKUESI
Emiljano Dika

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006